

Data 16.05.2022

**STATUTI I SHOQERISE DHE**  
**AKTI I THEMELIMIT**  
**TE SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**"Etiqua" SH.P.K**

**Shtetasi:**

Jusel Mici i lindur me 17.11.1992 ne Tirane , me banim ne Tirane identifikuar me ane te Kartes se identitetit J21117083U madhor me zotesi te plote per te vepruar, krijon Shoqerine me pergjegjesi te kufizuar "Etiqua" SH.P.K , me seli ne Rrugen : Njesia Administrative Kashar , Rruga dytesore Vore -Tirane ,Ndertesa Nr 10 Kati i pare . Statuti eshte akti baze ku do te mbeshtetet themelimi i shoqerise tregtare "Etiqua " SH.P.K si dhe Zhvillimi i metejshem i saj .

**KREU I**

**NENI 1**

**DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

1.1 Ortaku i vetem i shoqerise eshte Jusel Mici i lindur me 17.11.1992 ne Tirane me banim ne Tirane identifikuar me ane te Kartes se identitetit J21117083U madhor me zotesi te plote per te vepruar, i cili zoterne 100% te kapitalit te shoqerise.

**NENI 2**

**EMERTIMI I SHOQERISE**

21. Shoqeria mban emrin "Etiqua" SH.P.K dhe eshte person juridik shqiptar.

21. Kjo shoqeri e fiton personalitetin e saj juridik me regjistrimin e saj ne Qendren Kombetare te Biznesit .

22 Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara ne aktin e themelimit dhe statutit, si dhe ne kontratat respektive.



### NENI 3

#### SELIA E SHOQERISE

3.1. Shoqeria "Etiqua" SH.P.K, e ka qendren "Njesia Administrative Kashar , Rruga dytesore Vore -Tirane ,Ndertesa Nr 10 Kati i pare .ne Tirane dhe gezon te drejten per te hapur dege dhe zyra te perfaqesimit te tjera ne Shqiperi dhe jashte saj.

3.2. Njesite strukturore, deget dhe perfaqesite do te ndertohen konform legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe me ate te vendeve te tjera ku ajo mund te hape dege.

### NENI 4

#### OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE

4.1. Objekti i Veprimtarise se Shoqerise eshte . Shitje me pakice dhe shumice te artikujve promocionale, stampime, printime dhe fushata Promocioni, . Menaxhimi i rrjeteve sociale. Reklamimi ne rrjetet sociale , telemarketing, call center etj. Sherbime pastrimi.

4.2. Aktivitetet e siperpermendura do te realizohen duke respektuar legjislacionin shqiptar ne fuqi dhe konform me programin e aktivitetit ekonomik dhe financiar, te miratuar nga ortakut i vetem i saj.

4.3. Shoqeria mund te zgjeroje ose kufizoje fushen e veprimtarise se saj ne cdo kohe.



## NENI 5

### PERGJEGJESIA E ORTAKUT TE VETEM

5.1. Pjesemarrja ne shoqeri nuk pengon pavaresine ligjore, organizative dhe te pronesise se ortakut te vetem.

5.2. Ortaku i vetem qe merr pjese ne kete shoqeri, nuk eshte pergjegjes per detyrimet qe lindin gjate aktivitetit tregtar te shoqerise, pertej kapitalit themeltar te saj, qe vete ai ka nenshkruar, gjithashtu shoqeria nuk pergjigjet per detyrimet personale te ortakut te saj.

## NENI 6

### KOHEZGJATJA

6.1. Shoqeria do te ushtroje aktivitetin ekonomik te saj, per nje periudhe kohe te pakufizuar nga data e regjistrimit te saj.

## NENI 7

### SIMBOLET E SHOQERISE

7.1. Shoqeria do te kete vulen e saj "Etiqua "SH.P.K

## KREU II

## NENI 8

### KAPITALI I SHOQERISE

8. Kapitali i shoqerise "Etiqua "SH.P.K, eshte 1 000.000 leke e cili perbehet nga:

- 8.1. Kapitali para me vlere te barabarte me 1 000.000 (nje milion) leke
- 8.2. Kuotat e shoqerise do te ndahen ne nje kuote te vetme, te cilat do te zoterohen 100% nga ortakut i vetem i shoqerise.

1.2 Ortaku i vetem i shoqerise eshte Jusel Mici i lindur me 17.11.1992 ne Tirane me banim ne Tirane identifikuar me ane te Kartes se identitetit J21117083U madhor me zotesi te plote per te vepruar, i cili, zoterne 3 100% te kapitalit te shoqerise.



8.3. Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

## NENI 9

### TRANSFERIMI I KAPITALIT DHE I KUOTAVE

9.1. Kapitali themeltar ose pjese te vecanta te tij, jane te transferueshme nga ortaku tek te tretet. Transferimi i kapitalit apo pjeseve te tij nga Ortaku i Vetem ne favor te te treteve, kryhet gjithnje me akt noterial te posacem.

9.2. Shoqeria mund te rrisi kapitalin themeltar ose mund ta zvogeloje ate, por gjithnje jo nen kufirin e 1 000.000 (nje milion ) leke. zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit behet me vendim te ortakut te shoqerise dlie sipas parashikimeve te ligjit nr.9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

9.3. Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimeve dhe pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, dhe ne sherbime, nepermjet emerimit te nje eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre sipas kerkeses se administratorit.

9.4. Kapitali i regjistruar i shoqerise mund te zvogelohet me vendim te Ortakut te Vetem ne te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

9.5. Vendimi per zvogelimin e kapitalit i njoftohet prane Qendres Kombetare te Biznesit per regjistrim nga administratori, ne perputhje me nenin 43 te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit".



## NENI 10

### TRANSFERIMI I KUOTAVE

10.1. Kuotat e kapitalit te shoqerise dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashhegimnise;
- p) dhurimit;
- d) cdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

10.2. Ne rastin e kalimit të kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

10.3. Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e fiton ate, pergjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes, nga rasti i kalimit te kuotave, deri ne rastin e regjistrimit te kalimit te tij ne Qendren Kombetare te Biznesit, sipas nenit 43 te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "dhe ndryshimeve te mevonshme Per Qendren Kombetare te Biznesit". Regjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ.

10.4. Kalimi i kuotave kushtezohet nga e drejta e parablerjes se tyre nga ortaket e tjere te shoqerise.

### KREU III NENI11

#### ORGANI VENDIMMARRES

11.1. Ortaku i Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise, qe miraton c do ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

11.2. Ortaku i Vetem, vendos per shoqerine si:

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- b) emerimin dhe shkarkimin e adrnistratoreve;
- c) emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- p) mbikeqyijen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- d)perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- e) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve;



- f) ndryshimin e statutit, e selise se shoqerise, hapjen dhe mbylljen e filialeve te saj.
- g) zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te shoqerise dhe riorganizimin dh e prishjen e shoqerise etj.

11.3. Të gjitha vendimet e marra nga Ortaku i Vetem duhet te regjistrohen në regjistrin e vendimeve, te dhenat e te cilit nuk mund te ndryshohen ose te fshihen.

Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

11.4. Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

11.5. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

## NENI 12

### ADMINISTRATORI

12.1. Administrator i shoqerise eshte Jusel Mici.

12.2. Administratori i shoqerise do te ushtroje kompetencat e administrimit per nje afat 5 vjecar me te drejte ripertesitje bazuar ne nenin 95/1 te ligjit nr.9901 date

14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

Administratori i shoqerise mund te caktohet edhe nje person tjeter, jashta orakeve.

## NENI 13

### KOMPETENCAT DHE PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT



13.1. Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshem dhe të jashtëzakonshem të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga ai vetë.
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatise dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara Ortakut të Vetem.

d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligj për Qendrën Kombëtare të Biznesit ;

e) raportojë përpara Ortakut të Vetem në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

13.2. Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjithë personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve.

13.3. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakeve.

13.4. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

NENI 14

VITI FINANCIAR



Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Djeter.  
Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise  
ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

#### NENI15

##### BILANCI I SHOQERISE DHE DIVIDENTET

15.1. Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Asamblese  
se Pergjithshme, e perbere nga Ortaku i Vetem miraton bilancin e paraqitur  
nga Administratori.

15.2. Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme, e perbere nga Ortaku i vetem  
vendos rreth shperndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te  
meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

#### NENI 16

##### MBARIMI I SHOQERISE

16.1. Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themehmin e saj;
- b) rre vendim të Ortakut te Vetem ;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar  
pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë  
3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit ";
- d) me vendim të gjykatës;

16.2. Ne kete rast, Ortaku i Vetem merr vendim me shkrim qe parashikon  
menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe  
shenuar

ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën  
shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".



8



16.3. Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

16.4. Nëse Ortaku i Vetem nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### **NENI 17**

#### **TRANSFORMIMI I SHOQERISE**

17.1. Transformimi i shoqërisë bëhet me vendim të Ortakut të Vetem ose kur ekzistojnë faktore të jashtëm detyrues ligjore, në këto raste vendimi merret pasi është paraqitur një raport mbi gjendjen e shoqërisë nga ana e administratorit.

17.2. Çdo transformim i bërë në kundërshtim me këto nen është i pavlefshëm.

#### **NENI 18**

#### **BAZA LIGJORE**

18.1. Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plote me këto statut dhe dispozitat e legjislationit shqiptar.

18.2. Për sa nuk parashikohet në këto statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe akteve të tjera ligjore dhe nenligjore të dale në zbatim të tyre në Republikën e Shqipërisë.

#### **NENI 19**

#### **MOSMARREVESHJET**

19.1. Për mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tjerëve, do të tentohet të zgjidhen me konsensus dhe mirekuptim.



19.2. Ne rast te kundert, kompetente per zgjidhjen e mosmarreshjeve do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor, Tirane,

## NENI 20

### DISPOZITA PERFUNDIMTARE

20.1. Ky statut eshte hartuar me vullnetin e lire dhe te plote te Ortakut te Vetem dhe eshte nenshkruar prej tij.

## Neni 21

### Klauzole mbyltese

20.1 Ky Statut hartohet ne 4 (kater) kopje me fuqi te njëjtë ligjore.

## ORTAKET THEMELUES

"Etiqua" SH.P.K

